

# DITARI MUJOR

NËNTOR 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTËR SHTETI PËR  
ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE ANTIKORRUPSIONIN

## LANÇOHET STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2024-2030, PIRDENI: VIZION I RI ME FOKUS SEKTORËT ME RISK TË LARTË KORRUPSIONIT

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni prezantoi Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030. Qëllimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, përmes një qasje të integruar, e cila përfshin parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin adreson sfidat kryesore të luftës kundër korrupsionit. Në Strategji janë evidentuar sektorët më të rrishtuar ndaj të cilëve do të të ketë vigjilencë të shtuar për llogaridhënie më të madhe dhe transparencë të plotë në kryerjen e detyrave nga institucionet. Mes këtyre sektorëve renditen Pronat, Tatimet dhe Doganat, Shëndetësia, Kontratat Publike (Prokurimet dhe Konkensionet) dhe Arsimi. Zgjerimi i veprimit të strategjisë shtrihet në mënyrë kapilare në qeverisjen vendore, në sektorin privat si dhe forcon edukimin



## BUDAPEST, MINISTRJA PIRDENI TAKON SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË NATO-S, MARK RUTTE

Ministrja Pirdeni ishte pjesë e delegacionit të kryesuar nga Kryeministri Edi Rama në takimet bilaterale të Komitetit Politik Evropian, të mbajtur në Budapest, Hungari. Gjatë këtyre takimeve, ministrja Pirdeni dhe Kryeministri Rama zhvilluan bisedime të rëndësishme me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Z. Mark Rutte, dhe Kryeministrin e Hollandës, Z. Dick Schoof. Në takime theksi u vendos tek çështjet e sigurisë dhe bashkëpunimit rajonal në një moment kyç për stabilitetin evropian. Tirana do të mirëpresë vitin që vjen, delegacionet e mbi 47 shteteve të Komunitetit Politik Evropian.



## OGP Mbledh në Tiranë Ministrat e Rajonit, Pirdeni: Çojmë përpara Agjendën e Reformave

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni deklaroi në Takimin e Ballkanit Perëndimor për Qeverisjen e Hapur se tre faktorë kyç, "transparenca, integriteti dhe llogaridhënia në administratë dhe institucione", do të jenë pjesë e pandarë e rrugëtimit të Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Për herë të parë, Shqipëria mirëpriti takimin e Ballkanit Perëndimor për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur (OGP), ku të pranishëm ishin ministrat e administratës publike të Rajonit të cilët diskutuan për ndërtimin e një strategjie të përbashkët për përbashkimin e sfidave rajonale në drejtim të qeverisjes së hapur dhe transparente.



## MINISTRJA PIRDENI MIRËPRET ZËVENDËSKRYEMINISTRIN E MAQEDONISË SË VERIUT, ARBEN FETAI

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni mirëpriti Zëvendëskryeministrin për Qeverisje të Mirë të Maqedonisë së Veriut, Arben Fetai. Gjatë takimit ministrja Pirdeni dhe zëvendëskryeministri Fetai shkëmbyen një diskutim të frytshëm mbi sfidat e përbashkëta të dy vendeve, dhe domosdoshmërinë për të koordinuar bashkëpunimin për qeverisjen e mirë. Në këtë kuadër, ministrja Pirdeni bëri një paraqitje të reformave të ndërmarra deri më tani në funksion të mirëqeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit. Të dy vendet janë në një moment tejet të rëndësishëm të rrugëtimit në Bashkimin Evropian, ndaj edhe në këtë drejtim ministrja Pirdeni theksoi se integrimi në BE dhe avancimi i reformave janë dy procese thellësisht të ndërlidhura.



## NISMA OGP, MINISTRJA PIRDENI TAKOHET ME HOMOLOGËT E RAJONIT: AVANCOJMË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN TË BP

Ministrja Pirdeni ka zhvilluar takime bilaterale me ministrat e rajonit, të cilët ndodhen në Tiranë në kuadër të takimit Rajonal të Ballkanit Perëndimor për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur. Gjatë takimit me ministrin e Administratës Publike të Maqedonisë së Veriut, Z. Goran Minçev, u diskutua për rëndësinë e shkëmbimit të praktikave më të mira mes administratave publike të dy vendeve. Ndërsa në takimin me ministren e Administratës Publike dhe Qeverisjes Vendore të Serbisë, Znj. Jelena Zariç Kovaçević, u theksua rëndësia e forcimit të kapitalit njerëzor në administratën publike dhe mundësitë për bashkëpunim përmes projekteve të përbashkëta që synojnë krijimin e një administrate më transparente dhe efikase.



## PRISHTINË, KONFERENCA E UNODC, PIRDENI: SHQIPËRIA PO INTENSIFIKON PËRPPJEKJET KUNDËR KORRUPSIONIT

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, mori pjesë në konferencën rajonale me tematikë mbi praktikat më të mira në parandalimin e korrupsionit, organizuar nga UNODC dhe UNDP. Në fjalën e saj, ministrja Pirdeni theksoi rëndësinë e angazhimit të përbashkët rajonal për të forcuar mekanizmat e qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme, duke vënë në dukje se Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) përbën kornizën kryesore globale për këtë përpjekje. Gjithashtu, ministrja Pirdeni vuri në dukje se Reforma në Drejtësi po rishkruan façen e re të Shqipërisë evropiane duke kontribuar në mënyrë thelbësore për avancimin e procesit të aderimit në BE. Sot, 98% e gjyqtarëve dhe prokurorëve i janë nënshtruar procesit të Vetingut në Shqipëri.



## MINISTRJA PIRDENI MERR PJESË NË KONFERENCËN RAJONALE NË SHKUP: ADMINISTRATA E MOTIVUAR, VIJON TRANSFORMIMI DHE ENERGJIZIMI I SAJ

Ministrja Pirdeni mori pjesë në konferencën rajonale në Shkup me tematikë "Qeverisja e Gjeneratës së ardhshme: Nxitja e inovacionit të shërbimeve publike në Ballkanin Perëndimor", organizuar nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) dhe OECD/SIGMA. Ministrja Pirdeni prezantoi punën drejt ndërtimit të një administrate publike moderne, inovative, të qëndrueshme dhe me fokus qytetarët. Inovacioni është themeli i reformave transformuese që janë ndërmarrë dhe një motor i rëndësishëm për të çuar përpara agjendën për qeverisjen e mirë. Ministrja përmendi gjatë fjalës së saj se tri janë shtyllat kryesore të inovacionit në transformimin e institucioneve publike në Shqipëri: Përmirësimi i shërbimeve publike të orientuara drejt qytetarëve; investimi me mekanizma bashkëkohorë në kapitalin njerëzor dhe përdorimi i Inteligjencës Artificiale për të përshpejtuar aderimin në BE.



## HUNGARIA DO TË TRAJNOJË NËPUNËSIT SHQIPTARË PËR INTEGRIMIN NË BE: MINISTRJA PIRDENI NËNSHKRUAN PLANIN E VEPRIMIT NË BUDAPEST

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, dhe Ministri i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Hungarisë, Z. Péter Szijjártó, kanë nënshkruar në Budapest Planin e Veprimit për trajnimin e nëpunësve të institucioneve shqiptare në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hungaria, me përvojën e saj do të ndihmojë Shqipërinë përmes programeve të dedikuara të trajnimit dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Në kuadër të marrëveshjes, Akademia Diplomatike Hungareze do të organizojë seminare për nëpunësit publikë shqiptarë, duke u fokusuar në përgatitjen për sfidat dhe arritjen e standardeve që kërkon procesi i negociatave me BE-në. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, Ministrja Pirdeni e vlerësoi Planin e Veprimit si një hap të rëndësishëm për forcimin e administratës publike shqiptare dhe përgatitjen e saj për integrimin në BE.



## HIDHET HAPI I RADHËS DREJT BASHKIMIT EVROPIAN: SHQIPËRIA PRANOHET SI VËZHGUESE NË RRJETIN EVROPIAN TË ADMINISTRATËS PUBLIKE



Shqipëria ka bërë sot një hap tjetër të rëndësishëm në rrugën drejt integritimit evropian, duke u pranuar si vëzhguese në Rrjetin Evropian të Administratës Publike (EUPAN). Njoftimi u bë gjatë takimit të nivelit të lartë të mbajtur në Budapest më 28-29 nëntor, organizuar në kuadër të Presidencës Hungareze të Këshillit të BE-së. Në emër të qeverisë Shqiptare, shefja e Stafit të Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Fotjona Taçe përshëndeti takimin dhe vendimin pozitiv, duke e vlerësuar pranimin e Shqipërisë në EUPAN si një mundësi të artë për të forcuar bashkëpunimin me vendet anëtare të BE-së dhe për të ndarë përvojat në reformimin dhe modernizimin e administratës publike. Përgjatë takimit 2-ditor, drejtoresha e Inovacionit pranë AKSHI-t, Znj. Romina Kostani, prezantoi avancimin transformues të Shqipërisë në digjitalizimin e shërbimeve publike dhe përdorimin e AI me synim rritjen e efikasitetit të administratës publike dhe përshpejtimin e proceseve teknike përgjatë fazës negociuese me BE-në.

## MINISTRJA PIRDENI TAKON REKTORIN E UNIVERSITETIT TË SHËRBIMIT PUBLIK LUDOVIKA

Në Budapest, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni u takua me rektorin e Universitetit të Shërbimit Publik Ludovika Dr. Gergely Deli, ku diskutoi mbi programet e trajnimit të nëpunësve publikë, si dhe vizionin për shndërrimin e ASPA-s në qendër ekselence në trajnimin e sektorit publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTËR SHTETI PËR  
ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE ANTIKORRUPSIONIN



Ministër i Shtetit për Administratën  
Publike dhe Antikorrupsionin  
Adea Pirdeni



mapa.gov.al  
adeapirdeni



APirdeni